

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË  
“SOCIIS” SHPK**

**TITULLI I  
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1  
THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot më datë 03.07.2018 themeluesi i vetëm krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin “**SOCIIS** shpk”, e cila vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare”.

Shoqëria do të ushtroj aktivitetin e saj edhe nën emrin tregtar **Zyra Ligjore “Sociis”/ “Sociis” Law Firm**.

Ortaku i vetëm është:

**Z.Noel Veizi**, i biri i Nevrus dhe Dodona, lindur më 07 Shtator 1983, në Lushnjedhe banuese në Tiranë në adresën: Rruga “Aleksandri i Madh”, Pallati GIRON, Shk. B, Ap.7/1, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës ei letrënjoftimit Nr.02469707.

**NENI 2  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë i shoqërisë “ ”shpk është:

Shërbime në fushën ligjore, ekonomikë, financiare, administrative, tregtare, fiskale marketingut, studimore, të ofruara nga personeli i licencuar/me dëshmi profesionale, për aktivitetet e mëposhtme:

- Shërbime avokatë e asistencë juridike për persona fizikë dhe/ose juridikë, shqiptarë dhe/ose të huaj, individe, OJF, OJQ, etj;
- Këshillime juridike për çështje ligjore;
- Hartimi i kontratave dhe marrëveshjeve që sjellin ose synojnë të sjellin pasoja juridike;
- Përfaqësim në gjykime për çështje penale, civile, administrative, tregtare, etj ne te gjitha shkallet e gjykimit brenda dhe jashte Shqiperise;
- Konsulencë ekonomike, studime, mënjanim i riskut në biznes;
- Vlerësime të gjendjes financiare të shoqërive tregtare, operacionet me kapitalet, kredit, investimet, nivelin optimal, dimensional, diagnozë strategjike financiare, etj;
- Themelim e regjistrim shoqërish tregtare, lidhje ortakërie, ndërmjetësime;
- Informacion tregtar, kërkime analiza e studime në marketing dhe strategji të tregut, të mallrave dhe të çmimeve;
- Konsulencë në fushën e patentave, markave, simboleve, etj, me mbrojtje të të drejtave të klientit në institucione kombëtare dhe ndërkombëtare;

- Konsulencë për marrëdhëniet me organet tatinore dhe doganore. Veprime për llogari të klientëve;
- Konsulencë për mbajtje kontabiliteti të shoqërisë cliente. Organizim e mbajtje kontabiliteti për klientët;
- Konsulencë dhe përfaqësim të klientit në prokurime e ankande;
- Konsulencë dhe përfaqësim të klientit në privatizime;
- Studime e realizm projektesh në fushën juridike, ekonomike, ambientale, demografike, shëndetësore, etj.;
- Çdo lloj veprimtarie tjeter të natyrës profesionale të lidhur më zhvillimin e veprimtarive të mësipërme;
- Bashkepunim me zyra, studio, avokate, juriste, individe te huaj / Shqiptare, qe jetojne, punojne jashtë vendit, ne fusha e me objekt bashkepunimi qe lidhet me aktivitetin e shoqerise, apo te ngashhem me te;
- Si dhe çdo sherbim tjeter te nevojshem e te kerkuar qe gjen mbeshtetje ligjore ne legjislacionin Shqiptar e nderkombetar ne fuqi.

### **NENI 3 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë “**SOCIIS**” shpk është e pakufizuar. Ajo mund të pushojet veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendim të Ortakut të Vetëm, sipas modaliteteve ligjore.

### **NENI 4 SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë “**SOCIIS**” shpk është në adresën: Rr. “Myslym Shyri”, NJ.B nr. 7, , pasuria nr. 4/201, ZK Nr. 8250 Tiranë, Shqipëri.

### **NENI 5 DEGET, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESEMARRJET**

Shoqëria, në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të cdo forme.

### **TITULLI II KAPITALI, KUOTAT**

### **NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind ) Lekë, i përbërë nga 1 kuote e barabarte me 100% te vleres se kapitalit, me vlerë nominale 100 (një qind) Lekë.

Zotëruar i vetëm i kapitalit themeltar është Ortaku i Vetëm i shoqërisë, Noel Veizi.

### **NENI 7 CERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT**

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

### **NENI 8 KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATE**

Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

Kuotat e kapitalit te shoqerise apo te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen si me poshte vijon:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shitblerje;
- trashegimi;
- dhurim;
- cdo menyre tjeter qe parashikohet ne ligj.

### **NENI 9 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Ortaku i Vetëm me vendim mund ta zmadhojë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të vendosi zvogëlimin e kapitalit themeltar.

### **TITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

### **NENI 10 FUNKSIONET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**



Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit mund të ndryshohen ose të fshihen

**TITULLI IV  
ADMINISTRATORËT**

**NENI 11  
EMËRIMI I ADMINISTRATORIT/EVE**

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për pesë vjet.

Administrator i shoqërisë “**SOCIIS**” shpk do të jetë, **Znj. Bea Alimadhi**, lindur në Tiranë, më 26/03/1993, banuese në Tiranë, në adresën rruga “Agim Qarri”, shtëpi private, në zotërim të pasaportës me nr.BG7643737 dhe Nr. personal O35326076F, me një kohëzgjatje të ushtrimit të detyrës për pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 12  
KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT**

Veprimitaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtroje të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Ligji.

**TITULLI V  
DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE**

**NENI 13  
DIVIDENDËT**

Pas përbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend



duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dyshëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tertiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

**TITULLI VI**  
**LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI**  
**NENI - 14**  
**Librat**

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra;

- 1-Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit te shoqerise apo gjate kryerjes se veprimtarise;
- 2-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese se ortakeve;
- 3-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Administratorit;
- 4-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal (ne rast se krijohet një i tille prane kesaj shoqerie ).

**NENI - 15**  
**Viti Financiar, Llogarite Vjetore, Eksperti Kontabel**

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik ne QKR dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor te atij viti. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vecanta te hartuara nga administrator miratohen nga asambleja e ortakeve.

**NENI - 16**  
**Percaktimi i Afatit te Veprimtarise**

Afati i veprimtarise eshte i percaktuar ne kete statut, por mund te ndryshohet nga asambleja e ortakeve.

**NENI - 17**  
**Prishja e Shoqerise**

Shoqeria do te shperbehet/prishet ne rastet si vijon:

- kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

-në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimitarisë tregtare;

-në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;

-në raste të tjera, të parashikuara në statut;

-në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

-për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

## **TITULLI VII PRISHJA DHE NJOFTIMET**

### **NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

### **NENI 19 NJOFTIMET**

Njoftimet që u bëhen ottakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose me letër rekomande me marrje përgjigje në adresat respektive

#### **NENI - 20 Dispozitat e fundit**

12.1. Ndryshimet ne Akt Themelinin e Shoqerise do te behen vetem me vendim shtese me shkrim te Asamblese se Shoqerise

12.2. Akti i Themelimit ka vlore ligjore i shoqeruar me Statutin e Shoqerise, te cilet nenshkuhen nga themeluesit e Shoqerise;

12.3. Ne rast te mosmarreveshjeve me pala te treta apo cdo lloj tjeter mosmarreveshjeje, kur keto te fundit nuk zgjidhen ne mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqjesor Tirane.

## **ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË “SOCIIS” SHPK**

NOEL VEIZI

*Noel Veizi*  
6 *Noel Veizi*